




Pikoret PVC

- Pikoret PVC janë profile plastikë me gjatësi 2.5m dhe rrjetë 10cm në të dy krahët e profilin këndor i cili përfundon me një dhëmb 6-7mm që shërben për orientimin e pikave të ujit jashtë strehës duke mënjanuar në këtë mënyrë formimin e lagështirës dhe dëmtimeve që vijnë prej saj. Pikoret PVC vendosen në streha, ballkone, parapete etj, për të mbrojtur ndërtesat nga ujrat kullues dhe lagështira që këto ujëra krijojnë. Ky produkt gjithashtu garanton edhe mbrojtjen mekanike, aspektin estetik të strehave të objektit si dhe lehtësi në punim në sipërfaqet e vështira. Fiksimi i pikoreve në suport kryhet me ngjitësin e polisterolit Center System Termo Capot ose me rrafshuesin Center Astar Universal.



Këndore PVC

- Këndoret PVC janë profile plastikë me gjatësi 2.5m dhe rrjetë 10cm në të dy krahët e këndit PVC. Këndet vendosen në qoshet e objektit, në dyer, dritare etj. Ky produkt garanton mbrojtjen mekanike, aspektin estetik të qosheve të objektit si dhe lehtësi në punimin e këtyre sipërfaqeve të vështira. Fiksimi i këndoreve në suport kryhet me ngjitësin e polisterolit Center System Termo Capot ose me rrafshuesin Center Astar Universal.